



Përmbledhje e disa rezultateve të Studimit Elektoral Shqiptar 2005

Pregatitur nga

Altin Ilirjani

Shoqata Shqiptare e Shkencave Politike (ALPSA)
Rr. Bogdani, Pall. 7, Apt. 4B,
P.O. Box 8199, Tirana, Albania
www.alpsa.org
alpsa@alpsa.org

Përmbledhje e disa rezultateve të Studimit Elektoral Shqiptar 2005

Studimi Elektoral Shqiptar 2005 është pjesë e një projekti akademik ndërkombëtar që drejtohet nga programi: Studimi Krahasues i Sistemeve Elektorale (CSES) i Universitetit të Miçiganit, Ann Arbor në ShBA. CSES mundëson studimin e sjelljes elektorale në mbi pesëdhjetë vende të botës dhe mbështetet nga Fondacioni Kombëtar i Shkencës së ShBA-së. Studimi Elektoral Shqiptar 2005 u përgatit nga Shoqata Shqiptare e Shkencave Politike (ALPSA) në bashkëpunim me kompaninë Globic Research LLC, ShBA. Financimi i Studimit në Shqipëri u bë nga Fondacioni Shqiptar i Shoqërisë së Hapur – Soros, dhe Ambasada Holandeze në Tiranë.

Studimi i zgjedhjeve të 2005-ës në Shqipëri u përqëndrua në tre tema kryesore: ndikimi i institucioneve politike në njohjen dhe sjelljen politike të shtetasve; natyra e ndasive politike, kulturore e sociale dhe përkatësive ideologjike në Shqipëri; dhe vlerësimi i institucioneve e proceseve demokratike. Një dataset i plotë i të dhënave do të depozitohet së shpejti në Universitetin e Miçiganit, Ann Arbor dhe do të jetë në dispozicion të kërkuesve në mbarë botën.

Intervistat u kryen në datat 4 - 20 Korrik 2005 me 1500 shtetas shqiptarë mbi 18 vjeç të përzgjedhur në mënyrë krejtësisht rastësore. Intervistat u kryen nëpër shtëpi dhe çdo intervistë zgjati mesatarisht 45 minuta. 48 përqind e intervistave (ose 705) u kryen në gjashtë rrethet kryesore të vendit të shpërndara në 83 njësi intervistimi (*Primary Sample Units*). Pjesa tjetër (ose 795 intervista) u kryen në rrethet e tjera të shpërndara në 90 njësi intervistimi. Rezultatet e Studimit, në nivelin e besueshmërisë 95 përqind, kanë një saktësi statistikore ± 2.2 përqind të rezultateve që do të merreshin po qe se do të intervistoheshin të gjithë shtetasit shqiptarë mbi 18 vjeç me banim në Shqipëri.

Pyetësori i Studimit përmban mbi 200 pyetje. Këtu po paraqesim rezultatet e një pjesë të variablave që mendojmë se mund të jenë me interes për një audience të gjerë jo-akademike. Studimi Elektoral nuk synon të konfirmoj rezultatet zyrtare të zgjedhjeve të 3 Korrikut 2005 por të jap informacion për të shpjeguar vendimin e votuesve. Për këto arsye, ky material paraqet informacion vetëm për ceshtjet kryesore të fushatës elektorale dhe problemet që shqetesojnë votuesit; vlerësimin e lidereve të katër partive politike kryesore gjatë fushatës elektorale; disa vlerësime për pritshmerite të votuesve nga maxhoranca e re politike; një vlerësim të opinionit publik për sistemin elektoral; dhe disa të dhëna demografike si p.sh. besimi fetar, perkatesia etnike, dhe nderthurja e nivelit të arsimimit dhe grupemoshave me identifikimin partiak.

Të dhënat e studimit tregojnë se votuesit shqiptarë kanë pikëpamje të forta dhe të sofistikuara për situatën politike dhe gjendjen e demokracisë në vend. Keshtu, nëse 96% e votuesve besojnë në demokraci dhe 63% kanë nivel të lartë të efikasitetit të tyre politikë (besimi se është e rëndësishme për individin të ushtrojë të drejtat e tij politike si p.sh. të drejtën e votës), më shumë se 60% e tyre shprehen të pakënaqur ose aspak të kënaqur me mënyrën se si funksionon demokracia në Shqipëri. Në të njëjtën kohë, rreth 94% e publikut mendon se liria individuale dhe të drejtat e njeriut në Shqipëri respektohen vetëm deri diku, dhe 40% shprehen se ato respektohen shumë pak ose aspak.

Dy partitë politike kryesore, Partia Demokratike në pushtet dhe Partia Socialiste, tashmë në opozitë, kanë baza të forta dhe të qëndrueshme në elektorat. Përfundimet e studimit sugjerojnë se ishte qëndrimi i votuesve kundrejt liderëve partiakë ai që luajti një rol kyç në vendimin për kë të votonin. Kështu, 56% e të intervistuarëve e karakterizuan ish- Kryetarin e Partisë Socialiste, Fatos Nano, si jo të sinqertë ose të ndershëm; 62% prej tyre ndanin mendimin se ai nuk mendonte aspak për problemet e tyre, dhe 53% u përgjigjën se ndjehen të zemeruar kundrejt tij. Në të gjitha këto dimensionet, lideri i Partisë Demokratike, Sali Berisha, është në pozita shumë më të favorshme me votuesit. Të paktën 57% e të intervistuarëve e karakterizojnë Berishën si të sinqertë dhe të ndershëm; 65% u përgjigjën se Berisha i ka bërë ata të ndjehen me më shumë shpresë për të ardhmen, dhe shumica besojnë se ai me të vërtetë mendon për problemet e tyre. Për më tepër, votuesit janë koshientë për instabilitetin politik dhe qeverisjen e dobët në vend. Të pyetur për problemin më të rëndësishëm që ka hasur Shqipëria katër vitet e fundit të qeverisjes socialiste, ata u përgjigjën duke i vendosur në të njëjtin nivel instabilitetin politik (shprehur rëndom si “sherret midis politikanëve”) dhe qeverisjen e dobët me problemet me ujën e pijshëm dhe ndërprerjet e energjisë elektrike, këto të fundit probleme të përditshme shqetësuese në Shqipëri.

Sipas këtij studimi, votuesit kanë opinione të qarta dhe jo të favorshme për Leka Zogun, pretendentin për fronin e mbretit të Shqiptarëve, dhe për lëvizjen e tij LZHK. Rreth 60% prej atyre të cilët kishin një opinion pozitiv për atë dhe lëvizjen që ai drejton u deklaruan si simpatizantë të Partisë Demokratike, dhe 40% si simpatizantë të Partisë Socialiste ose Lëvizjes Socialiste për Integrim (LSI). Për shkak të numrit të vogël të përkrahësve të Leka Zogut, këto vlerësime janë brenda kufijve të gabimeve statistikore në studimin tonë.

Vlerësimi i votuesve për liderin e LSI-së, Ilir Meta, ishte i gjithllojshëm. Rezultatet e studimit sugjerojnë se elektorati nuk ishte plotësisht i bindur për sinqeritetin e motiveve të tij politike. Për më tepër, del se votuesit nuk e vleresojnë atë si një lider shumë të fortë dhe të aftë, cilësi këto që ishin në qendër të strategjisë elektorale të LSI-së.

Në përgjithësi, mund të thuhet se kjo fushatë elektorale u dominua nga vlerësimet negative për lidhshëpinë e Partisë Socialiste dhe premtimet populiste të Partisë Demokratike. Rreth 40% e të pyeturve thanë se problemet më të rëndësishme me të cilët ata duan të merret qeveria e re janë papunësia dhe ulja e varfërisë, ndjekur nga lufta kundër korrupsionit. Në të njëjtën kohë, ata rreshtuan korrupsionin si problemin numër një që ka hasur Shqipëria këto katër vitet e fundit (në një pyetje tjetër, 78% e tyre u përgjigjën se besonin se marrja e rryshfetit është shumë e përhapur midis politikanëve). Duke akuzuar korrupsionin si shkaktarin kryesor të

gjithë problemeve në Shqipëri, Partia Demokratike kopjoi me sukses skenarin e fushatave elektorale populiste “me duar të pastra” që kemi parë në shumë vende të tjera, duke filluar nga Italia deri në Amerikën Latine. Gjithashtu, në momentin që korrupsioni dhe varfëria e madhe në vend u bënë çështjet dominuese të fushatës elektorale, edhe vlerësimi i publikut për Sali Berishën u bë në kontekstin e një lideri të ndershëm që kujdeset për të varfërit më shumë sesa si ish-President autoritar. Strategjia e fushatës elektorale të Partisë Socialiste e cila rikujtonte ngjarjet e vitit 1997 ndoshta ishte shumë e vonuar dhe jo sensitive ndaj problemeve që shqetësonin votuesit.

Të pyetur se kë do të dëshironin të ishte Kryeministri i ardhshëm i vendit, 26% e të intervistuarëve u shprehën për Sali Berishën; Edi Rama ishte zgjedhja e dytë me 21%. Për më tepër, Sali Berisha kishte mbështetjen e 55% të votuesve demokrat ose “votuesve blu”. Edi Rama ishte zgjedhja për Kryeministër e 32% e të intervistuarëve që u identifikuan me Partinë Socialiste, aleatët e saj ose me LSI-në. Është interesant fakti që Edi Rama ishte zgjedhja për Kryeministër e 6% të votuesve blu dhe 18% të votuesve të LSI-së.

Duke krahasuar moshën dhe identifikimin partiak, 70% e përkrahësve të Partisë Demokratike janë të grupmohave 18-49 vjeç. Rreth 68% e simpatizantëve të Partisë Socialiste janë 40 vjeç e sipër. Partia Demokratike kishte mbështetjen e 61% e të intervistuarëve në grupmohën 30-39 vjeç, dhe 54% në grupmohën 18-29 vjeç. Një shpjegim për këtë mund të jetë se grupmosha 30-39 vjeç i përket brezit të “revolucionit” anti-komunist, ose e thënë me fjalë të tjera, rinia që dominoi levizjen anti-komuniste në fillimin e viteve 90-të dhe i ka qëndruar besnike PD-së. Grupmosha 18-29 vjeç është rritur në periudhën post-komuniste kur Partia Socialiste ka qenë në pushtet për 8 vitet e fundit. Këta duket sikur kanë më tepër një ndjenjë proteste kundër Partisë Socialiste se sa një ndjenjë afrimiteti të fortë me Partinë Demokratike. Kjo tregohet nga fakti se edhe LSI-ja dhe Edi Rama kanë një mbështetje të konsiderueshme nga kjo grupmoshë. Lëvizja Socialiste për Integrim ka mbështetjen më të madhe prej grupmohave 18-29 vjeç dhe 40-49 vjeç. Në lidhje me nivelin e arsimimit dhe identifikimin partiak, bie në sy që Partia Socialiste dhe Lëvizja Socialiste për Integrim, së bashku, kanë një avantazh kundrejt Partisë Demokratike midis votuesve që kanë mbaruar studimet e larta ose pas-universitare.

Përsa i përket përkatësisë fetare dhe vet-identifikimit etnikë është e rëndësishme të kujtojmë se studimi ynë përfshin vetëm votuesit që banojnë aktualisht në Shqipëri. Të dhënat tona nuk thonë asgjë rreth emigrantëve Shqiptarë që jetojnë në vendet e tjera (sipas disa burimeve 30% e popullsisë). 70% e të intervistuarëve në studimin tonë u deklaruan si Mysliman por vetëm 7.5% e tyre e dinin nëse ishin Mysliman Syni apo Bektashi. Gjithashtu, më tepër se 46% e të pyeturve thanë se nuk e praktikojnë kurrë besimin e tyre fetar, dhe 14% shkojnë në kishë ose xhami shumë rrallë. Kjo mund të na bëjë të mendojmë se në Shqipëri përkatesitë fetare sot janë më tepër asocieme nominale sesa besime reale. Rreth 15% e të intervistuarëve u deklaruan si Ortodoks, dhe 13% si Katolikë. Përsa i përket identitetit etnikë, 96% e të intervistuarëve u vet-deklaruan Shqiptarë. Mes tyre, 16% u identifikuan si Gegë apo Toskë. Gegët kishin një prirje dy herë më të madhe për tu vetidentifikuar krahasuar me Toskët. Kjo mund të jetë pasojë e mënjanimet të tyre politik dhe social gjatë dekadave të regjimit komunist.

Studimi Elektoral Shqiptar është në radhë të parë një projekt akademik dhe produkti i tij kryesor është dataseti që do të depozitohet së shpejti në Universitetin e Miçiganit, Ann Arbor dhe do të jetë në dispozicion të kërkuesve në mbarë botën. Të dhënat e këtij studimi mund të përdoren gjithashtu edhe për krahasimin e ndryshimeve të opinionit publik për qeverinë e re të Partisë Demokratike gjatë katër viteve të ardhshëm. Në këtë kuadër, studimi ynë i ardhshëm është planifikuar të bëhet pas 100 ditëve të para të qeverisë së re në Dhjetor të këtij viti.

Proceset elektorale dhe opinioni publik qëndrojnë në qendër të çdo sistemi demokratik nisur nga fakti se interesi kryesor i demokracisë është të shndërrojë preferencat e publikut në politika. Shpresojmë që publikimi i këtyre rezultateve të ndihmojë lexuesit në kuptimin e sjelljes elektorale në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe të procesit demokratik në Shqipëri.

Pregatitur nga

Altin Ilirjani, PhD
Departamenti i Shkencave Politike
Universiteti i Karolines së Veriut në Chapel Hill, ShBA, &
Shoqata Shqiptare e Shkencave Politike (ALPSA), Tirane


Me shumë informacion për Studimin Elektoral Shqiptar 2005, organizimin dhe grupin e punës, mund të gjendet në adresat më poshte:

- Studimi Elektoral Shqiptar 2005, website (<http://www.alpsa.org/aes/>)
- Shoqata Shqiptare e Shkencave Politike (ALPSA), website (<http://www.alpsa.org/>)
- Comparative Study of Electoral Systems (CSES), website (<http://www.cses.org/>)
- Globic Research LLC (ShBA), Email (research@globic.us)

Studimi Elektoral Shqiptar 2005 u financua nga:


- Fondacioni Shqiptar i Shoqërisë së Hapur – Soros
website (<http://www.soros.al>)
- Ambasada Holandeze në Tirane
website (<http://www.netherlandsembassytirana.com/>)

C21. Ju lutem, më thoni sa dakort ose kundër jeni me thënien e mëposhtme: "Demokracia mund të ketë probleme, por është më e mirë se çdo formë tjetër qeverisjeje." Jeni shumë dakort, dakort, jeni kunder, apo shume kunder?




	Percent	Cumulative Percent
Shume dakort	43.5	43.5
Dakort	52.9	96.4
Kunder	2.5	99.0
Shume kunder	1.0	100.0
Total	100.0	

Sa i kënaqur jeni me mënyrën se si funksionon demokracia në Shqipëri?




	Percent	Cumulative Percent
Shume i kenaqur	3.4	3.4
Mjaftueshem i kenaqur	33.1	36.5
Jo shume i kenaqur	42.2	78.6
Aspak i kenaqur	21.4	100.0
Total	100.0	

C47. Sa respektohen liria individuale dhe të drejtat e njeriut sot në Shqipëri? A mendoni se liria individuale respektohet shumë, deri diku, pak, apo aspak?




	Percent	Cumulative Percent
Shume	6.0	6.0
Deri diku	53.8	59.9
Pak	26.1	85.9
Aspak	14.1	100.0
Total	100.0	

C20. Disa njerëz thonë se nuk ka rëndësi se për kë voton sepse asgjë nuk ndryshon. Të tjerë thonë se ka rëndësi për kë voton sepse kush është në pushtet mund t'i ndryshojë gjërat. Duke përdorur shkallën e vlerësimit në këtë tabelë, (ku NJËSHI nënkupton që të votosh nuk sjell ndryshim dhe PESA nënkupton se të votosh mund të sjellë ndryshime), ku e poziciononi ju veten?




	Percent	Cumulative Percent
Vota ime nuk sjell ndryshim	8.9	8.9
2	6.2	15.1
3	9.9	25.0
4	12.2	37.2
Vota ime sjell ndryshim	62.8	100.0
Total	100.0	

C13. Duke folur në përgjithësi për punën e qeverisë në tërësinë e saj, sa mirë ose keq mendoni ju se ka punuar qeveria socialiste në këto 4 vitet e fundit. Ka punuar shumë mirë? Mirë? Keq? Apo shumë keq?




	Percent	Cumulative Percent
Shume mire	2.9	2.9
Mire	44.4	47.3
Keq	33.0	80.3
Shume keq	19.7	100.0
Total	100.0	

C11. Cili mendoni se ka qënë problemi kryesor që ka hasur Shqipëria këto 4 vitet e fundit?




	Percent	Cumulative Percent
Korrupsioni	29.9	29.9
Papunesia	29.0	58.9
Varferia	17.1	75.9
Uji / Dritat / Rruget	4.6	80.5
Instabiliteti politik	4.4	84.9
Qeverisja e dobet	4.2	89.2
Moszbatimi i ligjeve	3.3	92.4
Rendi publik & krimi	2.5	94.9
Emigracioni i paligjshem	1.5	96.5
Arsimi	1.4	97.9
Integrimi ne BE	1.1	98.9
Taksat e larta	1.1	100.0

C48. Sa i përhapur është korrupsioni dhe marrja e rryshfetit tek politikanët në Shqipëri: shumë i përhapur, deri diku i përhapur, pak i përhapur, apo thujse nuk ndodh?



	Percent	Cumulative Percent
Shume i perhapur	77.9	77.9
Deri diku i perhapur	14.2	92.1
Pak i perhapur	3.0	95.1
Thuajse nuk ndodh	.8	95.9
Nuk e di	4.1	100.0
Total	100.0	




C28. Cila parti përfaqëson pikëpamjet tuaja më mirë?



	Valid Percent
PS	37.0
PD	47.1
LSI	9.3
PR	1.2
PSD	1.4
LZhK Leka Zogu	2.1
PDK	0.2
PBDNj	1.7


Note: Kjo nuk eshte perkatesia partiake e te intervistuarve

C67. Zgjedhjet e 3 Korrikut për shkak të rezultatit apo të mënyrës se si u zhvilluan, ju bën të ndiheni me shpresë? I frikësuar? I zemëruar?




		Percent
me shpresë?	Po	81.7
	Jo	18.3
i frikësuar?	Po	14.3
	Jo	85.7
i zemëruar?	Po	19.8
	Jo	80.2
	Total	100.0

C31. Në ditën e zgjedhjeve ne 3 Korrik, mes gjithë politikanëve në Shqipëri, cilin dëshironit të ishte Kryeministri i ardhshëm?




	Percent	Cumulative Percent
Fatos Nano	11.9	11.9
Sali Berisha	25.5	37.4
Ilir Meta	9.3	46.7
Edi Rama	20.9	67.6
Bamir Topi	7.6	75.2
Pandeli Majko	8.0	83.2
Vangjel Dule	1.0	84.3
Leka Zogu	1.7	86.0
Genc Ruli	1.0	87.0
Jozefina Topalli	6.7	93.7
Nuk e di	6.3	100.0


C31 / Blu. Në ditën e zgjedhjeve ne 3 Korrik, mes gjithë politikanëve në Shqipëri, cilin dëshironit të ishte Kryeministri i ardhshëm? *[Elektorati qe identifikohet me partite qe jane ne qeverine e re]*




C31 / Roze. Në ditën e zgjedhjeve ne 3 Korrik, mes gjithë politikanëve në Shqipëri, cilin dëshironit të ishte Kryeministri i ardhshëm? *[Elektorati që identifikohet me partitë që janë në opozitën e re]*



C31 / PID. Në ditën e zgjedhjeve ne 3 Korrik, mes gjithë politikanëve në Shqipëri, cilin dëshironit të ishte Kryeministri i ardhshëm? [Elektorati sipas tre partive kryesore]




C14. Cila është çështja apo problemi me i rëndësishem të cilin ju do të dëshironit që qeveria dhe parlamenti i ri i Shqipërisë të merrej gjatë muajve të ardhshëm?




	Percent	Cumulative Percent
Punesimi	34.8	34.8
Korrupsioni	16.5	51.3
Ulja e varferise	8.7	60.0
Uji / dritat / rruget	7.9	67.9
Rritja e pagave & pensioneve	6.0	73.9
Rendi publik	4.6	78.5
Zbatimi i ligjeve	4.2	82.7
Arsimi	3.3	86.0
Legalizimi i banesave	3.2	89.1
Ulja e taksave	3.1	92.2
Zhvillimi i bujqesise	2.5	94.8
Stabiliteti politik	2.2	97.0
Emigracioni & problemet e emigranteve	1.6	98.6
Integrimi ne BE	1.4	100.0

C14. Cila është çështja apo problemi i dyte me i rendesishem të cilin ju do të dëshironit që qeveria dhe parlamenti i ri i Shqipërisë të merrej gjatë muajve të ardhshëm?




	Percent	Cumulative Percent
Punesimi	20.3	20.3
Uji / dritat / rruget	14.5	34.8
Korrupsioni	14.1	48.9
Rendi publik	8.0	56.8
Ulja e varferise	7.7	64.5
Rritja e pagave & pensioneve	6.3	70.8
Arsimi	4.7	75.5
Zbatimi i ligjeve	4.6	80.0
Ulja e taksave	4.6	84.6
Emigracioni & problemet e emigrantëve	4.4	88.9
Integrimi ne BE	3.6	92.5
Zhvillimi i bujqesise	2.9	95.4
Legalizimi i banesave	2.8	98.3
Stabiliteti politik	1.7	100.0

C51. Krahasuar me 12 muaj më parë, mendoni se gjendja e përgjithshme ekonomike në Shqipëri është:







	Percent	Cumulative Percent
Shume e mire	1.2	1.2
Pak me mire	25.1	26.3
E njejte	38.2	64.4
Pak me keq	20.6	85.1
Shume me keq	14.9	100.0

C54. Si mendoni se do të jetë gjendja e përgjithshme ekonomike në Shqipëri pas 12 muajve të ardhshëm



	Percent	Cumulative Percent
Shume me mire	9.2	9.2
Pak me mire	51.0	60.2
E njejte	18.1	78.4
Pak me keq	4.4	82.8
Shume me keq	1.6	84.4
Nuk e di	15.6	100.0





Vleresime te kater lidereve kryesor ne fushaten elektorale [1]



Pyetja:

Sipas mendimit tuaj, shprehja “Ai është i sinqertë” e përshkruan [Emri politikanit] shumë mire, disi mirë, jo dhe aq mirë, apo aspak mirë?





Vleresime te kater lidereve kryesor ne fushaten elektorale [2]



Pyetja:

Sipas mendimit tuaj, shprehja “Ai prezanton një lidership të fortë” e përshkruan [Emri politikanit] shumë mire, disi mirë, jo dhe aq mirë, apo aspak mirë?





Vleresime te kater lidereve kryesor ne fushaten elektorale [3]



Pyetja:

Sipas mendimit tuaj, shprehja “Ai me të vërtetë mendon për njerëzit si ju” e përshkruan [Emri politikanit] shumë mire, disi mirë, jo dhe aq mirë, apo aspak mirë?

Vleresime te kater lidereve kryesor ne fushaten elektorale [4]




Pyetja:


Sipas mendimit tuaj, shprehja “Ai është i ditur” e përshkruan [Emri politikanit] shumë mire, disi mirë, jo dhe aq mirë, apo aspak mirë?

Reagime ndaj kater lidereve kryesor ne fushaten elektorale [1]


Fatos Nano, vetë si njeri, apo diçka që ai ka bërë, a ju ka bërë të shpresoni?




Sali Berisha, vetë si njeri, apo diçka që ai ka bërë, a ju ka bërë të shpresoni?



Ilir Meta, vetë si njeri, apo diçka që ai ka bërë, a ju ka bërë të shpresoni?



Leka Zogu, vetë si njeri, apo diçka që ai ka bërë, a ju ka bërë të shpresoni?




Pyetja:


[Emri politikanit], vetë si njeri, apo diçka që ai ka bërë, a ju ka bërë të shpresoni?

Reagime ndaj kater lidereve kryesor ne fushaten elektorale [2]


Fatos Nano, vetë si njeri, apo diçka që ai ka bërë, a ju ka bërë të frikësoheni?




Sali Berisha, vetë si njeri, apo diçka që ai ka bërë, a ju ka bërë të frikësoheni?



Ilir Meta, vetë si njeri, apo diçka që ai ka bërë, a ju ka bërë të frikësoheni?



Leka Zogu, vetë si njeri, apo diçka që ai ka bërë, a ju ka bërë të frikësoheni?




Pyetja:


[Emri politikanit], vetë si njeri, apo diçka që ai ka bërë, a ju ka bërë të frikësoheni?

Reagime ndaj kater lidereve kryesor ne fushaten elektorale [3]


Fatos Nano, vetë si njeri, apo diçka që ai ka bërë, a ju ka bërë të zemëroheni?




Sali Berisha, vetë si njeri, apo diçka që ai ka bërë, a ju ka bërë të zemëroheni?



Ilir Meta, vetë si njeri, apo diçka që ai ka bërë, a ju ka bërë të zemëroheni?




Leka Zogu, vetë si njeri, apo diçka që ai ka bërë, a ju ka bërë të zemëroheni?



Pyetja:


[Emri politikanit], vetë si njeri, apo diçka që ai ka bërë, a ju ka bërë të zemëroheni?

C55. Tani, më lejoni t'ju pyes për sistemin elektoral në Shqipëri. Sipas sistemit elektoral aktual, votuesi voton dy herë, një herë për kandidatin zonal dhe një herë për partitë në proporcional. Sipas mendimit tuaj, për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, a duhet të mbajmë të njëjtin sistem elektoral, apo të votojmë vetëm për kandidatët zonalë, apo vetëm për partitë në proporcional?



	Percent	Cumulative Percent
I njëjti sistem elektoral	40.8	40.8
Te votohet vetem per kandidatet	26.8	67.6
Te votohet vetem per partite ne proporcional	21.4	88.9
Nuk e di	11.1	100.0


C56. Sipas mendimit tuaj, kush duhet të vendosë se cili sistem elektoral është më i mirë për Shqipërinë, liderët e partive politike, ekspertët e OSBE-së, apo elektorati shqiptar?



	Percent	Cumulative Percent
Lideret e partive	11.7	11.7
Eskpertet e OSBE-se	20.7	32.4
Votuesit Shqiptar	61.3	93.6
Nuk e di	6.4	100.0

DISA TE DHENA DEMOGRAFIKE


D31. A i përkisni ndonjë besimi fetar? Cilit?



	Percent	Cumulative Percent
Musliman	62.7	62.7
Musliman Syni	1.5	64.2
Musliman Bektashi	6.0	70.2
Ortodoks	14.7	84.9
Katolik	13.2	98.1
Asnje	1.9	100.0
Total	100.0	


Sa e praktikoni fene tuaj? Sa here shkoni ne kishë ose xhami / teqe?

Sa herë shkoni në kishë ose në xhami / teqe?



	Percent	Cumulative Percent
Asnjehere	46.4	46.4
Shume ralle	14.0	60.4
Rralle	25.0	85.4
Shpesh	5.1	90.5
Shume shpesh	9.5	100.0

D33. Me cilin nga grupet etnike e identifikoni veten tuaj?



	Percent	Cumulative Percent
Shqiptare	80.1	80.1
Shqiptare-Gege	11.0	91.1
Shqiptare-Toske	5.1	96.2
Greke	1.8	98.0
Vllehe (Cobane/Arumune)	.7	98.7
Maqedonase	.7	99.5
Rome	.5	100.0
Total	100.0	

Figure No. 1
Afersia partiake dhe Grupemoshat ne elektorat.




Figure No. 2
Grupemoshat dhe afersia partiake ne elektorat.




Figure No. 3
 Afersia partiake dhe niveli arsimimit ne elektorat.




Figure No. 4
 Niveli arsimimit dhe afersia partiake ne elektorat.

